



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 5 nëntor 2025

VLERËSIM

Lënda: Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregullator (RIA) për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar”.

Vlerësimi i përgjithshëm: 94/100

Përgjithësisht pozitiv

A) Informacione të përgjithshme mbi procesin

Emërtimi i propozimit të politikës Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Ministria udhëheqëse	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
Numri/data e RIAs	2025 – MEI – Nr.5
Statusi	Finale
Data e marrjes për shqyrtim	11 gusht 2025
Data e komenteve të fundit	6 tetor 2025
Numri i komenteve të kryera/të reflektuara	40/41
Numri i ripunimeve	3

A) Konteksti i politikës

Qëllimi i kësaj nisme është harmonizimi i plotë i legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare me standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht me Direktivën e Kodifikuar (BE) 2017/1132, të ndryshuar. Kjo nismë synon të sigurojë përputhshmëri të ligjit shqiptar me *acquis communautaire*, duke krijuar një mjedis ligjor më të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe transparent për bizneset dhe investitorët. Në këtë kontekst, projektligji adreson boshllëqet ekzistuese ligjore nga themelimi dhe regjistrimi i shoqërive e deri te raportimet e detyrueshme, në mënyrë që çdo çështje juridike të trajtohet sipas kërkesave të direktivave të BE-së. Përmes këtyre ndryshimeve synohet gjithashtu rritja

e konkurrencës dhe përmirësimi i klimës së biznesit në Shqipëri, duke nxitur një mjedis më të favorshëm për sipërmarrjen dhe investimet afatgjata.

B) Vlerësimi i përgjithshëm

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë mjaftueshmërisht cilësore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar

C) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë **plotësisht** në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të thellohet më tej analiza ekonomike sasiore ekonomike (kosto/përfitimi), për të gjitha grupet e prekura.
2. Te redaktohet nga ana gramatikore raporti për të përmirësuar qartësinë e tij.